



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201401348/6

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandim për referimin në organin e prokurorisë të veprës penale "Dhuna në familje" kryer ndaj shtetases R.I..*

**Drejtuar :** Shefit të Komisarariatit të Policisë  
Z. Arjanit Arapi

Sarandë

I nderuar Z. Arapi,

Sikurse ju kemi vënë në dijeni, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja R.I. me banim në fshatin Gjashtë, Sarandë. Ankuesja shkruan se, është e martuar, ka një fëmijë dy vjeç, bashkëshortin e ka në burg dhe aktualisht banon në një banesë me familjarët e tij. Mbrëmjen e datës 26.03.2014 ajo është dhunuar fizikisht nga familjarët e bashkëshortit, si vjerri L.I., vjerra N.I., kunati E.I. dhe kunata F.I.. Qëllimi i ushtrimit të dhunës fizike ndaj saj ishte për ta detyruar atë që të dilte nga dhoma e të largohej nga banesa.

Ankuesja pretendon se, ka marrë në telefon policinë në numrin 129 dhe pasi i ka treguar ngjarjen e ndodhur i ka kërkuar ndihmë. Për shkak të njoftimit të policisë, dhunuesit e kanë mbyllur atë në dhomë. Punonjësi i policisë që ka biseduar në telefon me ankuesen i ka thënë asaj që të shkonte në komisarariat, ndërkohë që ajo e ka informuar atë se nuk mund të lëvizte sepse e kishin mbyllur me çelës. Po atë natë ajo e ka gjetur mundësinë dhe ka shkuar në komisarariat, por sapo ka mbriritur në polici ka humbur ndjenjat për shkak të dhimbjeve. Për shkak të kësaj gjendjeje shëndetësore ajo është shtruar në Urgjencën e Spitalin Sarandë. Të nesërmen në datën 27.03.2014 i kanë shkuar në spital punonjësit e policisë dhe i kanë marrë kallëzim.

Ankuesja pretendon se, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Sarandë nuk i kanë ardhur në ndihmë në kohën që ajo e kërkoi atë dhe se ndjekja e këtij rasti është kryer me vonesë. Gjithashtu ajo pretendon se, nga ky komisarariat nuk është marrë asnjë masë ndaj dhunuesve të cituar më sipër dhe se nuk i është dhënë asnjë informacion se çfarë është bërë me kallëzimin e saj.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën 2871/1 Prot., datë 19.08.2014 ndërmjet të tjerash na informoni se në librin e dinamikës së këtij komisarariat pasqyrohet njoftimi i ankueses R.I. për ushtrim dhune fizike nga vjerri dhe vjerra

e saj, i bërë në datën 26.03.2014, ora 21.15, si dhe numri i telefonit të saj. Po kështu rezulton se, ajo në datën 26.03.2014, ora 22.30, ka shkuar në Urgjencën e Spitalit Sarandë dhe është vizituar e mjekuar. Për këtë rast është njoftuar ndihmës specialisti i rendit të zonës Ilir Shena.

Gjithashtu ju na informoni se, nga pyetja e punonjësit të policisë të zonës rezulton që, ai pasi është njoftuar ka shkuar në spital dhe ka marrë kontakt me ankuesen, ka kryer veprimet hetimore duke plotësuar urdhrin e mbrojtjes për të dëmtuarën, si dhe ka bërë shoqërimin e shtetasve L.I. dhe N.I. në komisariat. Materialet e mbajtura për këtë rast i janë dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Sipas përgjigjes tuaj, veprimet e policisë në këtë rast kanë qënë konform ligjit dhe shtetasës R.I. i është dhënë ndihma në kohën e duhur, dhe se ajo është njohur me vendimin e gjykatës për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes.

Gjithashtu ju na informoni se, në muajin maj 2014 bashkëshorti i ankueses F.I. është arrestuar dhe në muajin qershor 2014 ajo është larguar me dëshirën e vet së bashku me fëmijën tek prindërit e saj në qytetin e Fierit.

Nga ankesa e shtetasës R.I. dhe përgjigjia juaj konstatojmë se, për këtë rast organi i policisë nuk e ka kryer detyrën ligjore në mënyrë të plotë dhe konform ligjit sikurse pretendoni ju.

Edhe pa marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e ankueses ndaj policisë, por vetëm t'i referohemi përgjigjes tuaj rezulton se, policia është mjaftuar vetëm me bërjen e kërkesës drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes në favor të ankueses. Ky veprim parashikohet në nenin 13/1/c të Ligjit Nr. 9669 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare".

Ju sjellim në vëmendje se dhuna në familje përbën vepër penale e parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, të ndryshuar. Për ndjekjen, administrimin dhe referimin në organin e prokurorisë të materialeve procedurale lidhur me këtë vepër penale punonjësit e Komisarariatit të Policisë Sarandë nuk kanë kryer asnjë veprim. Ky qëndrim provon më së miri faktin se punonjësit e policisë nuk e kanë kryer plotësisht detyrën e ngarkuar me ligj. Rasti konkret kërkonte që punonjësit e policisë, me atributet e policisë gjyqësore të kryenin me iniciativë veprimet e para hetimore në mënyrë të menjëhershme dhe të plota. Pasi u vunë dë dijeni të veprës penale, të merrej kallëzimi të dëmtuarës, të pyeteshin të katër autorët e veprës penale vjerri L.I., vjerra N.I., kunati E.I. dhe kunata F.I., të administroheshin të gjitha provat e mundshme, të bëhej vendimi për ekspertim mjeko-ligjor i të dëmtuarës etj.

Ju sjellim në kujtesë se për shkak të përhapjes dhe rrezikshmërisë së lartë të këtij fenomeni regresiv të ushtrimit të dhunës në familje në vendin tonë, veçanërisht ndaj grave, disa prej të cilave fatkeqësisht kanë humbur edhe jetën, autorët e kësaj vepre penale të kryer në bashkëpunim duhet të ishin arrestuar në kushtet e flagrancës. Nëse nuk do të arrestoheshin të katër autorët, mund të arrestohej ai që rezultonte kryesor dhe me rrezikshmëri shoqërore më të madhe.

Mirëpo sikurse rezulton nga përgjigjia juaj, këto veprime të detyrueshme ligjore të parashikuara në nenet 30/1, 293 dhe 294 të Kodit të Procedurës Penale nuk janë kryer dhe vepra penale nuk i është referuar organit të prokurorisë.

Ndërkohë ju kujtojmë edhe përmbajtjen e nenit 24 të Ligjit Nr. 9669 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ku parashikohet se: "*Lëshimi i*

*urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale”.*

Gjithashtu ne vlerësojmë se, për shkak të këtij qëndrimi të policisë dhe gjendjes së pasigurisë që i është krijuar ankueses ajo është detyruar që të largohet nga banesa bashkëshortore.

Për sa më sipër dhe të rivendosur të drejtën ligjore të cënuar ankueses, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave të nevojshme organizative për kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale, lidhur rastin e shtetases R.I., për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal dhe referimin e saj në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

2. Ky rast të analizohet me objektivitet dhe të nxirret përgjegjësitë ligjore ndaj punonjësve të policisë që nuk ka kryer detyrën konform ligjit.

3. Shkeljet e konstatuar dhe masat e mara të përgjithësohen me qëllim të mos përsëriten raste të tilla në ta ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi që të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar në nenin 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**